



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 17.07.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 17 korrik 2018, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”, i cili është propozuar nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121, të Kushtetutës, si dhe ka ndjekur hapat e përcaktuara në nenin 17 të Ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Projektligji është hartuar në bashkëpunim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat do të jenë njëherazi edhe zbatueset e saj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve zëvendësministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Kospiri si dhe specialistë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Marrëveshja e huasë e propozuar përmes këtij projektligji është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.206, datë 11.4.2018, dhe parashikon shtimin e vlerës së huas në shumën 11 milionë USD.

Marrëveshja bazë e huas është ratifikuar me ligjin nr.84/2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit “Modernizimi i Asistencës Sociale””. Sipas kësaj marrëveshjeje IBRD-ja ka akorduar shumën prej tridhjetë e tetë milionë euro (38,000,000 euro), për të ndihmuar financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale, duke mbështetur kështu zbatimin e reformave nga ana e Huamarrësit për përmirësimin e barazisë dhe efikasitetit të programeve të tij të ndihmës sociale.

Projekti bazë përbëhet nga 2 pjesë, konkretisht:

- **Pjesa 1:** Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale, përmes mbështetjes së zbatimit të përmirësuar si e programit të ndihmës ekonomike edhe e programit të aftësisë së kufizuar nëpërmjet dhënies së financimit për rimbursimin e pagesave që Huamarrësi ka bërë nga alokimet e tij buxhetore për programin e ndihmës ekonomike.
- **Pjesa 2:** Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e ndihmës sociale përmes:
 - ✓ Dhënies së asistencës teknike për rishikimin e parametrave të programeve të ndihmës sociale;
 - ✓ Dhënies së asistencës teknike për mbështetjen e zhvillimit të një sistemi të informacionit për menaxhimin;
 - ✓ Dhënies së asistencës teknike për promovimin e transparencës në komunikime dhe monitorim dhe vlerësim;
 - ✓ Ofrimit të mbështetjes së zbatimit të projektit nëpërmjet financimit të kostove operative dhe dhënies së konsulencës për të përmirësuar ekspertizën teknike.

Marrëveshja bazë është ndryshuar 2 herë, respektivisht përmes:

- Ligjit nr. 117/2016 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “modernizimi i asistencës sociale”, të ratifikuar me ligjin nr. 84/2012. Përmes këtij ndryshimi.
- Ligjit nr. 113/2017, “Për ratifikimin e dokumenteve ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale, ratifikuar me ligjin nr. 84/2012.

Pala Shqiptare ka kërkuar pranë IBRD një financim tjetër shtesë në mbështetje të aktiviteteve të reja, të cilat detajohen në Skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe konsistojnë kryesisht në sa më poshtë vijon:

- **Pjesa 1:** Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale, përmes mbështetjes e zbatimit të përmirësuar, si e programit të ndihmës ekonomike (PNE), ashtu edhe e programit të aftësisë së kufizuar (PAK).
- **Pjesa 2:** Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e asistencës sociale përmes mbështetjes për zbatimin e përmirësimeve në dhënien e pagesave të asistencës sociale, përmes sa më poshtë:

Huaja e akorduar nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ka termat financiarë të mëposhtëm:

- **Shuma:** 11 000 000 USD;
- **Interesi:** bazuar në normën e referencës + marzh të pandryshueshëm;
- **Tarifa Front-end:** 0.25% e shumës së huas;
- **Komision angazhimi:** 0.25%, që përlllogaritet mbi vlerën e padisbursuar të huas;
- **Maturimi:** 27 vjet, duke përfshirë periudhën prej 7 vitesh pa pagesë principali.

Projekti do të jetë pjesë e parashikimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Afati i fundit për tërheqjen e fondeve të akorduara nëpërmjet kësaj marrëveshjeje huaje është data 30 qershor 2021.

Në përfundim të diskutimeve, duke vlerësuar projektin e “Modernizimit të asistencës sociale” të një rëndësie të veçantë në kuadër të reformës për zbutjen e varfërisë, rritjen e transparencës, cilësisë së shërbimeve, përdorimit me efektivitet të fondeve buxhetore si dhe përjashtimit të rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike ashtu edhe termat e huasë së dhënë nga IBRD si mjaft të favorshme, anëtarët e Komisionit e miratuan projektligjin me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORE

KRYETARI

Antoneta DHIMA

Erjon BRAÇE

Vendimet e KLSH-së lidhur me këtë marrëveshje:

KLsh ka pasur objekt të auditimit disa here këtë marrëveshje dhe në përfundim të auditimit ka nxjerrë edhe vendimet përkatëse konkretisht:

- Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 147 datë 10.10.2014 “Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale, Rinisë dhe Sporteve, për projektin SAMP “Modernizimi i Asistencës sociale”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga 01.01.2013 deri 31.12.2013.
- Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 46 datë 30.04.2014, “Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për projektin “Modernizimi i asistencës sociale”, me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën nga fillimi i projektit deri 28.02.2014.
- Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.121, datë 18.09.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për projektin “Modernizimi i asistencës sociale”, me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën nga fillimi i projektit deri 31 Dhjetor 2014.
- Vendimi nr. 146, Datë 19/12/2016 “Për evadimin e materialeve të auditimit financiar të ushtruar mbi programin e ndihmës ekonomike në projektin “Modernizimi i asistencës sociale” në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- Vendimi nr. 59, datë 12/06/2017, “Për evadimin e materialeve të auditimit financiar të ushtruar mbi programin e ndihmës ekonomike në projektin “modernizimi i asistencës sociale” në ministrinë e mirëqenies sociale dhe rinisë

Sipas vendimit të fundit nr. 59, datë 12/06/2017, lidhur me shtimin e afatit përcaktohet:

“Zgjatja e afatit të përfundimit me 1.5 vite ka sjell mos përmbushje të objektivave dhe shfazim pasi në bazë të PAD projekti duhet ti siguronte shtetit shqiptar mbulimin e 20% të kostos së NE për 5 vite ndërkohë që kjo shumë jo vetëm që është zvogëluar por dhe është shtrirë në kohë duke u zgjatur për 1.5 vite, pasi nuk janë realizuar indikatorët e projektit dhe mbulimi i huas është 14.6% i kostos së NE në 6.5 vite.

Gjithashtu nga grupi auditimit gjykohet se, në bazë të ecures së deri tanishme ku janë realizuar 9 DLI në 5 vite, zgjatja e afatit të zbatimit të projektit nuk do të jetë e mjaftueshme për përfundimin e tij (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 29-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)”

